


Vrasja dhe plagosja në Klinë, arrestohen disa persona



28/04/2022 23:24



Pesë persona janë arrestuar në lidhje me vrasjen e sontme që ndodhi në Klinë.

Kjo është konfirmuar nga Policia e Kosovës, rajoni i Pejës, shkruan lajmi.net.

Nga këta pesë persona, tre janë arrestuar e dy janë shoqëruar.

“Tre persona janë arrestuar që dyshohet se janë të involvuar në rast dhe dy të tjerë janë shoqëruar”, kanë konfirmuar nga Policia.

“Klina Info”, medium lokal i njohur në Klinë, ka shpalosur detaje nga ngjarja e ndodhur.

Siç raporton mediumi, pak para rastit viktimat ishin duke ngrënë iftar në restorantin që ndodhet aty afër.

Pas kësaj, ata kanë dalë nga restoranti ku jashtë ishin disa persona duke pritur, me të cilët janë përleshur.

Për pasojë, njëri nga dy vëllezërit ka mbetur i vrarë teksa tjetri i plagosur.


Nga Policia e Kosovës kanë thënë për lajmi.net se ata janë informuar në orën 20:43 minuta për rastin.

Fadil Gashi nga Policia e Pejës ka bërë të ditur se me të marrë raportimin, njësitet policore kanë dalë në vendin e ngjarjes ku është vërejtur se janë dy persona të plagosur.

Fatkeqësisht, njëri nga të plagosurit nuk ka mundur t’u shpëtojë plagëve.

Në 20:43 minuta policia është njoftuar se ka të shtëna me armë zjarri dhe dyshohet për të plagosur. Me të arritur në vend të ngjarjes, është konstatu se dy persona janë të lënduar. Janë dërguar në Qendrën e mjekësisë familjare pastaj janë dërguar në emergjencën e Pejës. Pas pak kohe, mjeku kujdestar e ka konfirmuar vdekjen e njëres viktimë”, tha Gashi. **/Lajmi.net/**

Artikuj të ngjashëm



April 29, 2022

Ish-gjykatësi i EULEX-it zgjidhet kryetar i Kushtetueses në Speciale



April 29, 2022

Aktakuzë ndaj gjakovarit: Shiste 100-euro false për 20 euro origjinale



April 29, 2022

Mushkolaj: Martin Berishaj nuk duhet mbrojtur, duhet shkarkuar sa më shpejtë



April 29, 2022

Lushtaku insiston në shkarkimin e ambasadorit Berishaj: Po dëmtohet imazhi i...



April 29, 2022

Vdekje e dyshimtë në Prishtinë, një femër gjendet pa shenja jete...



April 29, 2022

Kurti reagon për zgjedhjen e Abazoviqit kryeministër: Mezi pres të punojmë...

LAJME TË FUNDIT




Ermal Krasniqi, lojtari i javës në BKT Superligë



Ish-gjykatësi i EULEX-it zgjidhet kryetar i Kushtetueses në Speciale



Tyson Fury lë të hapur mundësinë e rikthimit në WWE



Mushkolaj: Martin Berishaj nuk duhet mbrojtur, duhet shkarkuar sa më shpejtë